

Në zbatim të :

VKM-ve **Nr. 779, datë 26.12.2018 (Cikli I)**
Nr. 40, datë 23.01.2019 (Cikli I)
Nr. 251, datë 27.03.2020 (Cikli I)

“Për disa ndryshime në **VKM NR. 269, Datë 29.3.2017**, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”

Nr. 778, datë 26.12.2018 (Cikli I)

"Për një ndryshim dhe shtesë në **VKM nr.288, datë 21.5.2018** "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”,

Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të dorëzojnë studentët për Përrjashtimin nga Tarifa (Cikli i parë Bachelor)

Nr	Kategoria	Dokumentacioni i nevojshëm i studentit
1	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;	<ul style="list-style-type: none"> • Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetim nga Njësia administrative vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike
2	Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë;	<ul style="list-style-type: none"> • Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetim studentit nga institucionet publike IAL
3	Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;	<ul style="list-style-type: none"> • Kopje ID • Vërtetim i pagesës nga DRSSH • Noterizim i vendimit të K.M.C.A.P
4	Studentët, të cilët kanë, të paktën, njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;”	<ul style="list-style-type: none"> • Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetimi pagesës nga DRSSH • Noterizim i vendimit të KMCA.P për prindin me aftësi të kufizuar.
5	Studentët, të cilët i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;	<ul style="list-style-type: none"> • Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetimi pagesës së pensionit nga DRSSH
6	Studentët, të cilët janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë;	<ul style="list-style-type: none"> • Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetimi që të dy fëmijët e parë janë studentë në IAL Publike
7	Studentët, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;	<ul style="list-style-type: none"> • Kopje kartë indentiteti • Vërtetim të statusit të jetimit
8	studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;	<ul style="list-style-type: none"> • Çertifikate familjare & Kopje ID • Vendim gjykatë të formës së prerë
9	Studentët, të cilët janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;	<ul style="list-style-type: none"> • Kopje ID • Vërtetim nga Ministria e Brendshme.
10	Studentët, të cilët janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;	<ul style="list-style-type: none"> • Kopje ID • Shkresa nga Ministria përkatëse.
11	Studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit;	<ul style="list-style-type: none"> • Kopje ID • Formulari i vetëdeklarimit

12	Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.”.	<ul style="list-style-type: none"> • Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetim nga instituti i të përndjekurve politikë
13	Mesatare 9-10	<p style="text-align: center;">Cikli i parë (Bachelor)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin e parë, listat vijnë në Ministria e Arsimit dhe Sporteve. • Për vitin e 2-të dhe të 3-të listat vijnë nga Sekretaria Mësimore
14	Mesatare 6-9	<p style="text-align: center;">Cikli i parë (Bachelor)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Listat vijnë nga Sekretaria Mësimore e FEUT

Dokumentacioni dorëzohet pranë Degës së Shërbimeve FE-UT (kati i dytë godina 3-katëshe A përballë A 204) brenda datës 10 nëntor 2023 ora 9:00-15:00 Email: degasherbimeve@feut.edu.al